

SQ

7002 POWER XP



SANITEC

PETRA NOVA



PËRSHKRIM	Detergjent alkalin me efektshmëri të lartë për pastrimin e sipërfaqeve prej guri natyral dhe artificial me porozitet të lartë dhe të ulët.
KARAKTERISTIKAT	Veçanërisht i efektshëm për largimin e papastërtive të yndyrshme, shtresave të holla me papastërti, koreve, njollave të sulfacionit dhe depozitimeve sipërfaqësore të të gjitha llojeve. Produkt me veprim të shpejtë. Nuk lë aroma të pakëndshme gjatë përdorimit.
PËRDORIMI DHE KOMPATIBILITETI	Përdorimet: sipërfaqe prej guri natyral (p.sh. travertin, gur Trani, gur Luserna, gur Leçe, ardezë, shkëmb ranor, karpuro, porfir, shtuf, peperino, gurë spur, granit, sienit, mermer etj.), sipërfaqe prej guri artificial (p.sh., tulla ballore, tulla të pjekura, klinker, gres, çimento, beton etj.). Mos e përdorni mbi metale dhe dru.
MËNYRA E PËRDORIMIT DHE DOZIMI	Gatë për përdorim. Pasi të keni hequr pluhurat, aplikojeni produktin direkt në sipërfaqe me ndihmën e një peneli ose një bidoni me grykë spërkatëse. Fërkojeni sipërfaqen me penel, furça dhe/ose një furçë të vetme me qime të përshtatshme. Produkti duhet të veprojë për disa minuta. Vazhdoni me fazën e shpëlarjes duke përdorur një hidropastruese me presion të ulët ose me dorë duke përdorur një furçë të njomur me ujë.
SPECIFIKIMET	Paraqitja: lëng transparent i verdhë pH: 13,5 +/- 0,5 Pesha specifike [g/ml]: 1,260 +/- 0,020
MASAT PARAPRAKE PËR PËRDORIM DHE RUAJTJE	Të ruhet në enët origjinale. Të shmangen temperaturat ekstreme. Për më tepër informacione mbi përdorimin dhe flakjen, shihni fletën e të dhënave për sigurinë.
PËRBËRJE KIMIKE	Për më tepër informacione mbi përbërësit e produktit, shihni fletën e të dhënave për sigurinë.
PARALAJMËRIME	PRODUKTI ËSHTË I PËRSHTATSHËM VETËM PËR PËRDORIM PROFESIONAL. Informacionet e përfshira në këtë Fletë të të Dhënave Teknike, rekomandimet për përdorim dhe aplikimet e produktit bazohen në njohuritë tona dhe në testet e kryera mbi produktin deri në datën e përpilimit të këtij dokumenti. Produkti mund të ketë aplikime të ndryshme dhe kushtet e funksionimit mund të ndryshojnë sipas materialeve dhe kushteve mjedisore për të cilat ne nuk jemi në dijeni. Për këtë arsye, Italchimica nuk mund të jetë përgjegjëse për përshtatshmërinë e produktit dhe rezultatet për proceset tuaja duke mos njohur detajet e kushteve tuaja të përdorimit. Për të konfirmuar përshtatshmërinë rekomandojmë të kryeni prova në një pjesë të vogël të sipërfaqeve. Firma nuk mban asnjë përgjegjësi në rast se produktet e saj përdoren në mënyrë të gabuar. Shërbimi ynë teknik është i disponueshëm për të gjetur kushtet optimale për të përdorur produktet.

**PROFESSIONAL
ACADEMY**



Get more information
on your smartphone.



PALLETIZATION	CODE	7002	EAN	8050999570383		
	Pcs x Box	2	Volume L	5	Fl. Oz.	169,07
	Box x Layer	18	Peso Kg	5,5	Oz.	194,01
	Box x Pit	72				

WWW.SANITECITALIA.COM

LAST UPDATE: 13/12/2021

REV. 00/2021